



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS
NË SHËRBIM TË FUQIZIMIT TË KËRKUESËVE TË RINJ
DHE TË STUDENTËVE”**

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

EKIPI I PROJEKTIT:

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI (koordinatore)

Anëtarë të personelit akademik

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Prof. Dr. Eldina Nasufi

Prof. Asoc. Dr. Elona Toro

Prof. Asoc. Dr. Migena Alimehmeti

Dr. Bora Kuçuku

Prof. Asoc. Dr. Alba Frashëri

Dr. Drita Rira

Prof. Asoc. Dr. Klementina Shiba

Prof. Asoc. Dr. Lorena Dedja

Prof. Asoc. Dr. Fjoralba Dado

Anëtarë të personelit ndihmës-akademik

Znj. Klodeta Alushani

Znj. Sema Hysa

Znj. Vasilika Mulla

Z. Dejan Kushta

PARTNERË:

Universiteti i Poitiers, Francë

Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF)

Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD)



PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe të zgjerimit të ofertës së programeve që ofron, synon të hapë një program të ri në Ciklin e parë të studimeve, i cili do të përgatisë përkthyes në gjuhën e shenjave. Ky program i ri vjen si nevojë e identifikuar pranë bashkësisë së njerëzve që nuk dëgjojnë nëpërmjet Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë por edhe nga mungesa e vërejtur pas krahasimit të ofertës së programeve universitare të kësaj tipologjie me universitetet në vendet e Bashkimit Evropian.



Në këtë projekt, FGJH ka mbështetjen, bashkëpunimin dhe ekspertizën e Universitetit të Poitiers në Francë me të cilin ka një marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi. Partner tjetër strategjik është Agjencia Ndërkombëtare e Frankofonisë (AUF) e cila përkrah dhe financo nisma inovative universitare dhe nxit shkëmbimet në nivel ndërkombëtar. Së treti, bashkëpunimi me ekspertët e Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), vlen për një qasje sa më konkrete dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ky projekt propozim është nisma fillestare konkrete për të hedhur hapat e parë për formimin e specialistëve interpretë të gjuhës së shenjave me diplomë universitare.



QËLLIMI

Qëllimi kryesor i këtij projekti është ngritja e infrastrukturës së nevojshme didaktike-mësimore dhe laboratorike në kuadër të krijimit të programit të ri të studimit Bachelor “Gjuhë frënge dhe gjuhë e shenjave shqipe”. Kjo infrastrukturë është e domosdoshme për zhvillimin dhe trajtimin e një kurrikule bashkëkohore të gjuhës së shenjave shqipe dhe ndërkombëtare dhe do të rrisë ndjeshëm kapacitetet e mësuesve, përkthyesve dhe interpretuesve të rinj të gjuhës së shenjave shqipe dhe ndërkombëtare.



Duke patur infrastrukturën e duhur, favorizohet dhe nxitja e sistemit arsimor gjithëpërfshirës të bazuar në parimet e barazisë dhe mësimin gjatë gjithë jetës si edhe mundëson formimin cilësor të të gjithë studentëve duke kontribuar në mirëqënien e tyre personale dhe duke reduktuar barrierat për studentët me aftësi ndryshe me qëllim përfshirjen dhe pjesëmarrjen në jetën akademike dhe studentore. Kjo krijon mundësi edhe në rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në programet e FGJH-UT.



OBJEKTIVAT

Nëpërmjet këtij projekti, synohen të përmbushen objektiva të natyrës infrastrukturore dhe didaktike-mësimore.

FAZA 1: OBJEKTIVA PËR ZHVILLIMIN INFRASTRUKTUROR

- Pajisja e një laboratorit me bazën e nevojshme materiale për përgatitjen e përkthyesve të gjuhës së shenjave;
- Ndërtimi i infrastrukturës TIK software me programe të përpunimit të videove dhe imazheve së bashku me aplikacione për mirëmbajtjen e tyre;
- Aftësimi i pedagogëve në përdorimin e pajisjeve për qëllime didaktike.



FAZA 2: OBJEKTIVA PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE DIDAKTIKE - MËSIMORE PËR KURRIKULËN E PROGRAMIT “GJUHË FRËNGJE DHE GJUHË E SHENJAVE SHQIPE”

- Zhvillimi i aftësive pedagogjike të ekipit mësimdhënës, ku përfshihen hartimi i programeve mësimore, përdorimi i metodave të mësimdhënies ndërvepruese, menaxhimi i grupit, vlerësimi i nxënësve, etj;
 - Përcjellja e njohurive dhe e aftësive specifike në kontekstin e përgatitjes së përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe;
 - Përmirësimi i aftësive aktive të komunikimit, të tilla si: riformulimi, përdorimi i mjeteve ndihmëse vizuale, etj;
 - Përforcimi i aftësive të menaxhimit të procesit mësimor si: menaxhimi i kohës, planifikimi i mësimit, logjistika, vlerësimi i rezultateve të të nxënit, etj;
 - Nxitja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional ku përfshihen eksplorimi i metodave të reja të mësimdhënies, përdorimin e teknologjive arsimore, përditësimin e njohurive në fushat përkatëse të ekspertizës, etj;
 - Përshtatja dhe harmonizimi i përmbajtjes mësimore të programit me nevojat e tregut të punës;
 - Zhvillimi i bashkëpunimit më grupet e interesit.
- 